



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KRYETARI I KOMUNËS

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, Ligjit 02/L-109 për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008 duke u bazuar në Vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Rekomandimet e IKSHP-së për marrjen e masave për mbrojtje nga pandemia Covid-19, në mbledhjen e shtabit Emergjent të Komunës së Lipjanit, Kryetari i Komunës nxjerr këtë:

VENDIM PËR ZBATIMIN E MASAVE SHITESË PËR PARANDALIMIN E PËRHAPJES SË PANDEMISË COVID-19

I. Duke u bazuar në rritjen e numrit të infektuarve me virusin COVID-19, Komuna e Lipjanit konform me Vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe legjislacionin në fuqi përcakton masa të reja shtesë, si vijon:

1. Apelojmë tek qytetarët e Komunës tonë të respektojnë masat mbrojtëse anti-covid në të mirë të shëndetit të popullatës.
2. Mobilizim maksimal i ekipeve të mjekëve në QKMF, formimi i ekipeve mobile të veçanta dhe sigurimi i masave mbrojtëse për ekipet mjekësore. Sigurimi i Automjetit të ndihmës së parë me dedikim të veçantë për të identifikuarit me COVID-19.
3. Të sigurohen hapësira të nevojshme në objektin e QKMF -së për ndonjë invazion eventual me të identifikuar me covid-19.
4. Ekipet e komunës për ndihma në ushqim - të riaktivizohen, të procedojnë me urgjencë për furnizim me produkte ushqimore për familjet në nevojë.
5. Të gjithë inspektorët e fushave tjera gjatë kësaj periudhe marrin autorizime shtesë në fushën e inspektoratit sanitar komunal, në shërbim të zbatimit të masave anti covid-19.
6. Inspektorët sanitar sipas Ligjit për sëmundjet ngjitëse të pajisin me vendime për vetëizolim çdo person të identifikuar me COVID-19 si dhe familjarët e tyre sipas protokolleve të IKSHP-së.

7. Obligohen Inspektorët sanitar të mbajnë evidencë të saktë në koordinim me drejtorin e QKMF-së për të evidentuarit me COVID-19 si dhe për të shëruarit.

8. Inspektoriati në bashkëpunim me Policinë e Kosovës të zbatojë masat e orarit të punës të bizneseve sipas vendimeve të Qeverisë së Kosovës.

9. Obligohen të gjitha bizneset shërbyese, hoteliere etj, që shërbejnë me tavolina të reduktojnë tavolinat dhe karriget në terasa dhe ambiente të hapura me distanca siq kërkohet në vendimet e Qeverisë.

10. Inspektorati të monitoroj dhe veproj sipas dispozitave ligjore në fuqi për mos përdoruesit e maskave dhe distancës sipas protokollit zyrtar.

11. Të gjithë punëtorët në të gjitha fushat e të bërit biznes obligohen të respektojnë distancën sociale dhe bartjen e maskave. Asnjë biznes nuk mund të shërbej konsumatorëve që nuk janë të pajisur me maska.

12. Të gjitha institucionet lokale komunale duhet të organizojnë punën duke krijuar kushte për distanca dhe përdorimin e maskave nga punëtorët dhe qytetaret.

1Nr. 500-28666

Lipjan, më 13.07.2020

